



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:194188

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05573459

P.nr.272/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit B.Z, për shkak të veprës penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1703/2022 të datës 30.09.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **07.02.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit B.Z, së bashku me mbrojtësin e tij av.Gani Kelmendi nga Istogu, sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 05.03.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B.Z, nga i ati M. dhe e ëma Sh. e gjinisë H., i lindur me datë ... në fshatin B. ku edhe jeton rr. “Daut Z.” Komuna I. , i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, pensionist, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal: ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me parë e gjerë me datë 22.08.2022, rreth orës 08:40 në rr. “D. Z.” në fshatin B., Komuna I., si pronar, ndërton objekt pa leje për të cilën kërkohet leje e tillë në bazë të ligjit për ndërtim dhe atë nenit 7 dhe 14, në atë mënyrë që i pandehuri ne vendin e lartcekur ne truallin e tij në njësinë kadastrale 740-09, fillon ndërtimin e shtëpisë për të cilën nuk kishte leje nga organet komunale, për çka një fakt të tillë e pohon edhe vetë i pandehuri, e ku me pasi hetohet edhe nga Policia e Kosovës ku dalin në vendngjarje me zyrtaret nga Drejtoria e Inspeksionit të Ndërtimit të

Komunës së Istogut, ku hartohet procesverbal mbi gjendjen ne teren dhe te pandehurit i ndalohe vazhdimi i punimeve.

- me çka ka kryer veprën penale **ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 2 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69 të KPRK-së dhe nenin 242, 364, 369 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurin e:

GJYKON

- I. Ashtu që, të pandehurit **B.Z.**, i shqiptohet **dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro** dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me burgim me pëlqimin e te pandehurit, konform nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet në **dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro**, të cilat dënime me gjobë, i pandehuri obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
 - Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron t'i paguan dënimet me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimet më gjobë do të zëvendësohen më dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do ti llogaritet me një (1) ditë burgim, *përkatësisht 30 ditë burgim.*
- II. **REFUZOHET** propozimi i prokurorisë për rrënimin e objektit lëndor i cili është filluar të ndërtohet pa leje, për faktin se i akuzuari pas ditës kritike është pajisur me leje ndërtimore për objektin lëndor.
- III. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë për paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Palë te dëmtuar nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1703/2022 të datës 30.09.2022 kundër të pandehurit B.Z, për shkak të veprës penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 07.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj dhe i pandehuri B.Z se bashku me mbrojtësin e tij av. Gani

Kelmendi nga Istogu sipas autorizimit, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri B.Z, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se paraprakisht ka aplikuar për leje ndërtimore para ditës kritike, mirëpo nga mosdija ka filluar ndërtimin për të cilin veprim është penduar, mirëpo pas ditës kritike është pajisur me leje ndërtimore për objektin lëndor.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e te pandehurit për veprën penale për te cilën akuzohet, një pranimi tillë u be ne mënyrë vullnetare dhe gjënë mbështetje te plote edhe me provat qe gjenden ne shkresa te lëndës, në rast qe gjykata vendos për pranimin e fajësisë propozoj qe si rrethanë renduese te merret parasysh shkalla e lartë e dashjes se kryesit duke qenë se siç u deklarua i njëjti ka qenë në njohuri për procedurën dhe nuk ka pritur pajisjen për leje, po ashtu ndonjë dënim eventual të mëparshëm penal, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, duke qenë se bazë të nenit 359 par.5 të KPRK-së ligjvënësi ka paraparë si normë imperative zbatimin e kësaj dispozite ku merret se kryerësi ka kryer veprën penale nga ky nen edhe pse i pandehuri është pajisur me leje ndërtimore, prokurori i shtetit nuk sheh bazë ligjore për tu tërhequr nga një propozim i përcaktuar në pikën IV të aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Gani Kelmendi ka deklaruar: se klienti im nga mosdija ka vepruar ne teren pa e pajisur administrata komunale e Istogut me leje, për çka këto veprime nuk i ka bërë me qellim të dëmtimit të askujt, meqenëse shtëpinë e ka ndërtuar në pllacin e vet, ka aplikuar për leje, ndërsa zhagitja e dhënies se lejes, ka qenë në arsyetimet e të njëjtëve qe kanë qenë ne grevë. Përkundër të gjithave i pandehuri ndjen keqardhje, tanimë është pajisur me leje ndërtimore ku një kopje te kësaj leje ia dorëzojmë gjykatës dhe prokurorisë në seancë, ndërsa sa i përket përfundimit dhe kërkesës së prokurorit se objekti i ndërtuar pa leje ne këtë çështje penale për të cilën tani i pandehurit është pajisur me leje, kërkesa e tyre qe objekti të rrënohet, është e pakuptimtë dhe e pa nevojshme. Kërkojmë nga gjykata qe duke i marr parasysh te gjitha rrethanat qe shqiptimi i dënimit te jetë sa me i ulët dhe meqenëse klienti im asnjëherë nuk ka qenë i dënuar me parë, ka konsideruar se kërkesa e tij në komunë por pa u pajisur me leje është e mjaftueshme për të startuar me punë, shtëpinë e ka ngritur në pronën e vet e po ashtu ka të paguar të gjitha taksat komunale qe parashihet, andaj i propozojmë gjykatës qe t'i këtë parasysh këto rrethana, gjithashtu pajtohem dhe japim pëlqimin se ne rast qe gjykata vendos qe të mbrojturit tim t'i shqiptohet dënim me burgim deri në gjashtë muaj i njëjti të zëvendësohet me dënim me gjobë.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve te lartcekura, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2,

nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për të cilën është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, nuk ka qenë i dënuar me parë, pas ditës kritike është pajisur me leje ndërtimore për objektin lëndor dhe rrethanat personale, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptojë rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepra penale, si dhe do të ndikojë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale, vendimin për zëvendësimin e dënimit me burgim më dënim me gjobë, e ka marrë konform nenit 44 të KPRK-së, meqenëse edhe i pandehuri përmes mbrojtësit të tij, ka dhënë pëlqim se në rast që gjykata i shqipton dënim me burgim deri në gjashtë muaj, i njëjti dënim të zëvendësohet në dënim me gjobë.

Vendimi për refuzimin e propozimit për rrenim të objektit

Gjykata, vendimin në dispozitiv të këtij aktgjykimi për refuzimin e propozimit të prokurorisë për rrenimin e objektit lëndor pa leje, e ka marrë për faktin se, pas ditës kritike dhe para se të përfundojë procedura me aktgjykim të formës së prerë në këtë çështje penale, këtu i akuzuari është pajisur nga e dëmtuara Komuna Istog me Lejen Ndërtimore për objektin lëndor e cila leje evidentohet me Nr. 11-351-41998/89 datë 04.10.2022. Për çka është vlerësuar nga gjykata se

objekti lëndor tani pas datës 04.10.2022, konsiderohet se është i ndërtuar me leje ndërtimore, dhe si rrjedhojë nuk mund të aplikohet neni 359 par.5 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës të precizuara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform neni 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesat pasurore-juridike

Në këtë çështje penale, sipas aktakuzës, nuk kishte të evidentuara palë të dëmtuara.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

Gjyqtari i vetëm gjykues
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*